

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës – Imazhet Dixhitale I – semestri I**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Arteve, DAB, Dizajn i Inovacionit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Imazhet Dixhitale I</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>E obligueshme</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>3</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>4</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>8</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Yllka Fetahaj</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>yllka.fetahaj@uni-pr.edu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<i>Gjatë vitit të tretë të studimeve, studentët do të përqendrohen në avancimin e njohurive të tyre teknike dhe artistike në fotografi. Lënda përfshin një theks të veçantë në ndriçimin natyral dhe artificial, përdorimin e ndriçimit në studio, pozimin për portrete, filtrat për ngjyra dhe bardh e zi, makrofotografinë dhe manipulimin digjital. Gjithashtu, studentët do të angazhohen në rikrijimin e fotografive të vjetra, zhvillimin e esesë fotografike dhe projekte konceptuale, me një hyrje në teknikat e avancuara të editimit dhe retouching-ut.</i>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<i>Me zhvillimin praktik të detyrave të aftësohen me teknikat dhe fushat e ndryshme të krijimit të fotografisë.</i>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Studentët do të jenë të aftë të përdorin me saktësi ndriçimin për fotografi profesionale në studio dhe terren.</li><li>- Do të zhvillojnë aftësi të avancuara në pozimin dhe fotografimin e portreteve, duke përdorur teknikat e ndryshme ndriçimi dhe filtrimi.</li><li>- Do të përvetësojnë bazat e editimit dhe fotomanipulimit digjital, duke qenë të aftë të realizojnë retouching të avancuar dhe projekte kreative.</li><li>- Do të jenë të aftë të krijojnë dhe prezantojnë projekte të strukturuar fotografike si eseja fotografike dhe fotografi konceptuale.</li></ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	30	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	30	60
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	1	10	10
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	1	1	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	1	1
Projektet, prezentimet, etj	1	2	2
<b>Totali</b>			<b>160</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Ligjërata teorike të kombinuara me punë praktike në studio dhe terren.</li> <li>-Workshops për teknika të ndriçimit, retouching, fotomanipulim dhe rikrijim fotografik.</li> <li>- Ushtrime praktike dhe projekte individuale, të realizuara në studio dhe darkroom.</li> <li>- Vizita në galeri dhe studio për të analizuar dhe diskutuar fotografi profesionale.</li> <li>- Prezantime të projekteve dhe diskutime të hapura me studentët për vlerësimin e punës së tyre artistike.</li> </ul>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjërata dhe praktika: 30%</li> <li>- Detyra praktike: 40%</li> <li>- Projekti përfundimtar: 30%</li> </ul>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Time –Life: <i>The Techniques of Photography</i></li> <li>Lou Jacobs JR.: <i>Studio Lighting</i></li> <li>Fil Hunter: <i>Light, Science &amp; Magic: An Introduction to Photographic Lighting</i></li> <li>Bruce Barnbaum: <i>The Art of Photography</i></li> <li>Andrew Faulkner: <i>Adobe Photoshop Classroom</i></li> </ul>		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<b>Hyrje në planprogram</b> Njoftimi i studentëve me planin e detajuar të vitit akademik, objektivat dhe mënyrën e vlerësimit.
<i>Java e dytë:</i>	<b>Teori: Drita natyrale dhe artificiale: Bazat e ndriçimit</b> Shpjegimi i teknikave bazë të përdorimit të dritës natyrale dhe artificiale për fotografi.
<i>Java e tretë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Eksperimentim me dritë natyrale dhe artificiale në studio dhe terren për të kontrolluar ndriçimin dhe hijet.
<i>Java e katërt:</i>	<b>Teori: Ndriçimi në studio</b> Përdorimi i pajisjeve të ndriçimit në studio, si reflektorët dhe softbox për të krijuar ndriçim të duhur.
<i>Java e pestë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Përdorimi i ndriçimit në studio për të krijuar efekte të ndryshme ndriçimi për portrete dhe produkte.
<i>Java e gjashtë:</i>	<b>Teori: Portreti dhe pozimi</b> Teknikat për portretizimin e subjekteve dhe pozimi për të nxjerrë në pah karakteristikat e tyre më të mira.
<i>Java e shtatë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Fotografimi i portreteve me dritë natyrale dhe artificiale dhe udhëzimi i subjektit për pozimin e duhur.
<i>Java e tetë:</i>	<b>Teori: Filtrat për ngjyra, bardh e zi, ND filters</b> Përdorimi i filtrave color-photo gels dhe bardh e zi për të krijuar efekte të ndryshme vizuale.
<i>Java e nëntë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Eksperimentim me filtrat color në studio
<i>Java e dhjetë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Eksperimentim me filtrat bardh e zi, ND filters në terren
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<b>Teori: Makrofotografia</b> Shpjegimi i teknikave për fotografimin e objekteve të vogla duke përdorur makro-lens apo filter për detaje të imta.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Makrofotografi në studio apo terren duke përdorur ndriçim dhe lensa të specializuara.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<b>Teori: Koha e ekspozicionit me flash</b> Shpjegimi i efektit të shpejtësisë së ekspozicionit kur përdoret drita flash dhe si ndikon ajo në ndriçimin dhe kapjen e subjektit.
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Eksperimentim me shpejtësinë e ekspozicionit duke përdorur flash për të krijuar lëvizje të ngrira ose efekte kreative me ndriçim të kombinuar.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Teori: Eseja fotografike:</b> Krijimi i një projekti të strukturuar Shpjegimi i mënyrës së krijimit të një eseje fotografike dhe zhvillimi i një historie përmes imazheve.

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës – Imazhet Dixhitale I – semestri II**

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Realizimi i një eseje fotografike duke përfshirë planifikimin, kompozimin dhe realizimin e serisë fotografike.
<i>Java e dytë:</i>	Prezantimi i esejave fotografike
<i>Java e tretë:</i>	<b>Teori: Rikrijimi i fotografive/pikturave të vjetra</b> Shpjegimi i procesit të rikrijimit të një fotografie apo pikturave të vjetër duke analizuar dritën, karakterin, veshjen dhe gjithë skenën.
<i>Java e katërt:</i>	<b>Puna praktike:</b> Rikrijimi i një fotografie të vjetër duke përdorur teknikë të ngjashme me origjinalin
<i>Java e pestë:</i>	<b>Vazhdimi i Punës praktike:</b> Rikrijimi i një fotografie të vjetër duke përdorur teknikë të ngjashme me origjinalin.
<i>Java e gjashtë:</i>	<b>Teori dhe praktikë: Bazat e editimit digjital</b> Prezantimi i softuerëve për editim digjital si Adobe Photoshop dhe Lightroom. Shpjegimi i teknikave bazë si rregullimi i ekspozimit, balancimi i ngjyrave, përdorimi i layers, dhe manipulimi i imazheve.
<i>Java e shtatë:</i>	<b>Vazhdim i punës praktike</b>
<i>Java e tetë:</i>	<b>Workshop për retouching,</b> ku studentët do të mësojnë teknikat e mësuara për retushimin e imazheve të portreteve dhe imazheve komerciale.
<i>Java e nëntë:</i>	<b>Fotografia konceptuale</b> Realizimi i një projekti konceptual përmes manipulimeve fotografike, duke kombinuar teknikat e fotomanipulimit në darkroom me procese digjitale.
<i>Java e dhjetë:</i>	<b>Vazhdim i punës praktike</b>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<b>Foto trip apo vizitë në ndonjë galeri/studio.</b>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<b>Foto dokumentar, film</b>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Prezantimi i punimeve, bisedë e hapur me studentë dhe vlerësimi artistik i punimeve.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Prezantimi i punimeve, bisedë e hapur me studentë dhe vlerësimi artistik i punimeve.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Pregaditja për ekspozitën e fundvitit.

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<i>Vijimi i rregullt i ligjëratave, angazhimi në klasë dhe realizimi i detyrave brenda afateve janë të detyrueshme për suksesin në këtë lëndë.</i>